



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina

<b>Datë/a:</b>	23.07.2021
<b>Referenc-ë:</b>	
<b>Për/ Za/ To:</b>	Klan Kosova
<b>Përmes/Preko/Through:</b>	Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
<b>Nga/ Od/ From:</b>	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike Kontrolloi: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
<b>Tema/ Subjekat/Subject:</b>	<b>Pëlqim</b>

Drejtorja për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën përmes emailit zyrtar nga Klan Kosova të cilët kërkojnë shfrytëzimin e hapësirës publike në Sheshin “Ibrahim Rugova” me datën 03.08.2021 nga ora 17:00 deri në 23:00.

Qëllimi i kërkesës është realizimi i një emisioni verorë emision ky i cili do të realizohet nga Durim Xhema, Nita Krasniqi dhe Kushtrim Bekolli ku si rekuizitë e emisionit do të jetë një autobus i brenduar me llogo të emisionit.

Drejtorja pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike nr.01-110-157481, i jep pëlqimin Klan Kosova për shfrytëzimin e hapësirës publike me datë 03.08.2021 në sheshin “Ibrahim Rugova” për realizim e emisionit veror ashtu siç është parashtruar në kërkesë.

**Kushtet e pëlqimit:**

- Nuk lejohet dëmtimi i pronës publike dhe çdo dëmtim eventual si pasojë e këtij aktiviteti do të jetë përgjegjësi e juaja;
- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.